




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dop. Dep. Dop.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 01-5025/11/a
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date 23.12.2011
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.12.2011, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me numër.AKK– 03-2542/11, për **z.Fikrim Damka** – Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqitën rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me numër.AKK– 03-2542/11, është trajtuar nën dyshimin e bazuar për Konflikt të mundshëm të Interesit, me veprimet e nevojshme të parapara sipas (Ligjit Nr.04/L-051), dhe atyre procedurale sipas (nenit 18.1 të këtij Ligji).

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës krahas pozitës së tij në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese më datë (19.05.2011), të cilës z. Damka i është përgjigjur pas një perjudhe të caktuar pasi që ka qenë jashtë vendit, me pastaj zyrtari i lartëpermendur ka komunikuar me ne, dhe jemi takur për të ballafaquar faktet.

Gjatë këtij takimi ku ishin prezent dy zyrtarë të Agjencisë i janë prezentuar dhe sqaruar se ka fakte të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e bazuar të Konfliktit të interesit.

z.Damka pasi ndegjoj faktet e prezentuara u pajtua se egziston gjendja e konfliktit të Interesit, mirpo u arsyetua se në kohën kur është propozuar për në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë nuk ka qenë deputetë i Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj u zotua se mbrenda afatit ligjorë do ta bëjë shmangijën e kësaj gjëndje.

Më datën 27.07.2011.z.Damka ka sjellur në Agjenci deklaratën me shkrim ku i drejtohet Komisionit për Regjistrimin të Popullsisë që jep dorheqje nga ky komision pasi që është në

gjëndje të Konfliktit të Interesit, e që është në kundërshtim me Ligjet e aplikueshëm në Kosovë e posaçërisht me ligjin Nr-02/L-133 dhe 03/L-135 mbi Parandimin e Konfliktit të Interesit .

Me pastaj Agjencia kundër Korupsionit ka komunikuar me Komisionin Qendrorë për Regjistrimin e Popullsisë për të vertetuar se a është pranuar kërkesa për dorheqje e z.Damka.

Me datën 03.08.2011, Komisioni Qendrorë për Regjistrimin e Popullsisë ka dërguar një shkresë ku ka njoftuar Agjencinë Kundër Korupsionit, se ka pranuar kërkesën për dorheqje nga z.Fikrim Damka, dhe që në mbledhjen e radhës pritet të qitet për votim dhe të miratohet nga anëtarët e KQR-së, sipas Ligjit Nr/03/L-237, për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Ndërsa me datën 23.11.2011, në adresën e Agjencisë kundër Korupsionit ka ardhur njoftimi për vendimin e KQR-së për aprovimin e kërkesës për dorheqje të anëtarit të KQRS-së z.Fikrim Damka.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj bazuar në veprimet e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor Agjencisë kundër Korupsionit

